

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 716 Prot.

Tiranë, më 04.072016

VENDIM Nr. 74, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për *Stacionet e Valvolave Bllokuese, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve (20 objekte)*, në kuadër të projektit "TAP"-shoqëria TAP-AG, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lorenc Bejko,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për *Stacionet e Valvolave Bllokuese, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve (20 objekte të listuara në vijim)*, në kuadër të projektit "TAP"-shoqëria TAP-AG, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lorenc Bejko.

Rajoni i Fierit

- BVS 32 Topojë (Stacion i valvolave bllokuese 32)
- APY 08 Mbrostar (Shesh i magazinimit të tubave 08)
- ACAMP 07 Mbrostar (Kampi i punëtorëve 07)
- BVS 31 Roskovec (Stacion i valvolave bllokuese 31)

Rajoni i Beratit

- BVS 30 Ura vajguore (Stacion i valvolave bllokuese 30) ***Ka gjetje arkeologjike***

Rajoni i Skraparit

- ACAMP 06 Vodica (Kampi i punëtorëve 06)
- BVS 29 Vërtop (Stacion i valvolave bllokuese 29)
- APY 06 Vodicë (Shesh i magazinimit të tubave 06) ***Ka gjetje arkeologjike***
- BVS 28 Vëndreshë (Stacion i valvolave bllokuese 28)
- APY 05 Buzuq (Shesh i magazinimit të tubave 05)
- ACAMP04 Çorovodë (Kampi i punëtorëve 04)
- APY 04 Çorovodë (Shesh i magazinimit të tubave 04)
- BVS 27 Potom (Stacion i valvolave bllokuese 27) ***Ka gjetje arkeologjike***
- ACAMP 03 Qafa (Kampi i punëtorëve 03)
- APY 03 Qafa (Shesh i magazinimit të tubave) ***Ka gjetje arkeologjike***

Rajoni i Korçës

- BVS 26 Vithkuq (Stacion i valvolave bllokuese 26)-të rrethohet struktura e evidentuar si varri mundshëm dhe evidentohet si zonë arkeologjike, gjatë punimeve të ndërtimit për BVS 26 për të shmangur dëmtimet e mundëshme
 - BVS 25 Drenovë (Stacion i valvolave bllokuese 25)
 - BVS 24 Progër (Stacion i valvolave bllokuese 24)
 - ACAMP 01 Eçmenik (Kampi i punëtorëve 01)
 - APY 01 Eçmenik (Shesh i magazinimit të tubave) ***Ka gjetje arkeologjike***
2. Shoqëria "TAP- AG" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit për të gjitha sheshet e Stacioneve të Valvolave Bllokuese, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve, të cilat sipas Raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor kanë rezultuar pa gjetje arkeologjike si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Për sheshet e Stacioneve të Valvolave Bllokuese, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve, të cilat sipas Raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor ***kanë rezultuar me gjetje arkeologjike, të hartohet Koncepti i sondazheve arkeologjike***, i cili të paraqitet në KKA e radhës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO